



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 9-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 12.12.2022, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 13,⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
4. Shahadije Bikliqi Dragaçina, anëtare
5. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
6. Enver Kryeziu, anëtar
7. Zoran Cirkovic, anëtar
8. Sllavisha Trajkovic

Të tjerë prezent

1. Lulzim Qerimi, nënkryetar i komunës
2. Shkelzen Hajdini, drejtor i drejtoratit për shëndetësi
3. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht

Të tjerë prezentë:

1. Përfaqësuesit e OSBE-së
2. Përfaqësuesit e UNMIK-ut

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**,

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se ftesën me material e keni marrë me kohë dhe e lexoi në vazhdim:

REND DITE

1. Aprovimi i Ekstrakteve nga mbledhja 8 të Komitetit për Komunitete
2. Informatë nga drejtorati për Shëndetësi për ecurinë e punëve në shëndetësi
3. Raporti mujor i punës së ZKK-së
4. Të ndryshme

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht me 8 vota aprovoi këtë:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i Ekstraktit nga mbledhja 8-të e Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime të ekstraktit nga mbledhja 8 -të e Komitetit për Komunitete?

Zoran Cirkovic, kam vërejtje pasi që është shënuar komiteti për komitete e duhet të jetë për komunitete

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht votoi.

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës.

II

Raporti mujor i punës së ZKK-së

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, ia kaloi fjalën Ledia Jovanovic, nga ZKK, e cili në pika të shkurta i njoftoi rreth kësaj pike

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Zoran Cirkovic, tha se ju falënderoj për bashkëpunimin që kemi pas, po ashtu tha se ndjem mire që disa propozime të cilat i kemi pas në komitet janë marr parasysh siç ka qenë rasti për DKA-në, për shkollën “Vëllezërit Aksiq në Lipjan, ku janë bërë disa punë të mira.

Gentiana Hoxhaj, tha se sa familje janë ndihmuar nga ZLK-ja, gjatë këtij viti.

Ledija Jovanovic, tha se janë ndihmuar 11 familje nga ZLK-ja, dhe 2 familje nga zyra e kryetarit.

III

Informatë nga drejtorati për Shëndetësi për ecurinë e punëve në shëndetësi

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, ia kaloi fjalën Shkelzen Hajdinit, drejtor i shëndetësisë, i cili në pika të shkurta i njoftoi rreth kësaj pike. Ku i

njoftoj rreth punëve të mira që po bëhen në këtë drejtorat, si dhe disa sfidave me të cilat po përballen si drejtorat.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se e falënderoj drejtorin për informatën, kam disa pyetje, e para fëmijët e komitetit RAE, po kemi informata që nuk po vaksinohen, duhet të bëhet një komision që të verifikoj këto raste.

Shahadije Dragaçina, tha se si është gjendja në QMF, në Janjevë, pasi që aty kanë qenë disa probleme me ngrohje. Si dhe çka po ndodh me renovimet që po bëhen në QKMF. Dhe pasi që do të ndërtohen QKMF-ja, e re pse po bëni renovime tani në të vjetrën.

Zoran Cirkovic, tha se e kam edhe një kërkesë për punësim për një qytetare e komunitetit e cila është e certifikuar dhe kë përvojë pune në shëndetësi, si do të ishte mundësia që ajo të punësohet.

Ana Guciq, tha se edhe unë e kam një kërkesë të njëjtë për punësim të komunitetit kroat në shëndetësi. Po ashtu kemi edhe një shqetësim prej banorëve të Janjevës pasi që nuk po kemi barnatore, dhe kjo po është problem për banorët e Janjevës.

Skender Bikliqi, tha se në Janjevë janë bërë disa punë të mira por duhet ende punë të bëhen, pasi që mungojnë disa aparatura, po ashtu mungojnë shpesh edhe materialet hargjuese.

Enver Kryeziu, tha se do të sihe mire që në QKMF, me qenë dikush që e mban rendin pasi që aty, pasi që po ndodh që shpesh herë po ka debate verbale në mes të pacientëve.

Shkelzen Hjadini, tha se sa i përket punësimeve le ti përcjellin konkursin dhe të aplikojnë, ndërsa janë komisionet që vendosin se kush i plotëson kushtet për punësim. Në QKMF-ju ka ndërpre kontrata për shkak të mos kryerjes së punëve si duhet. Sa i përket Janjevës janë bërë disa investime dhe pritet të bëhen edhe investime tjera.

Pastaj u kalua në pikën të ndryshme.

III

Të ndryshme

Zoran Cirkovic, tha se të ZLK-ja, janë disa vende të lira të punës, por me sa e di unë hale nuk janë plotësuar ato vende, a do të ketë ndonjë konkurs apo si do të jetë puna?

Skender Bikliqi, tha se ju falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin që kemi pas deri me tani si komitet, po ashtu ju uroj festat e fundvitit të gjithëve duke ju uruar shëndet e suksese në vitin në vijim

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15⁴⁵.

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit
Skender Bikliqi